

VENDIM
Nr.42, datë 13.7.2007

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR NDRYSHIMIN E KONTRATËS SË FURNIZIMIT
ME ENERGJI ELEKTRIKE PËR KLIENTIN E KATEGORISË FAMILJARE DHE
JOFAMILJARE**

Në mbështetje të nenit 9, pika 3, dhe nenit 44, pika 3, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 11 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.26, datë 13.5.2004, të ndryshuar, Bordi i Komisionereve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.7.2007,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për ndryshimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientin e kategorisë familjare dhe jofamiljare.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, si dhe Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për hartimin e ndryshimeve të kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientin e kategorisë familjare dhe jofamiljare, të miratuara me vendimin nr.40 dhe 41 të datës 31.8.2005 të Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta